



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA Durrës
KËSHILLI BASHKIAK**

PROCESVERBAL

Nr. 1, datë 06.02.2024

**I mbledhjes së Këshillit Bashkiak Durrës që zhvillohet në sallën e Këshillit
Bashkiak**

Orari i fillimit të mbledhjes : 12:15

Data e mbajtjes së mbledhjes : 06.02.2024

Mbajtja e mbledhjes : Salla e Këshillit Bashkiak

Lloji i Mbledhjes: Mbledhje e Radhës

Përfaqësuesit e Bashkisë Durrës: Zëvendëskryetari i Bashkisë z.Gentian Kallmi si dhe përfaqësues të drejtorive, që kanë përgatitur materialet për mbledhjen plenare.

Ani Dyrmishi: Përshëndetje të gjithëve.

Të nderuar Këshilltarë ! I nderuar Zëvendëskryetar ! Të nderuar të pranishëm!

Së pari dua t'Ju uroj një vit të mbarë e të paqtë dhe shpresoj të punojmë të gjithë së bashku për të mirën e qytetit dhe qytetarëve të Durrësit dhe jam i bindur që këtë vit do të kemi më shumë arritje. Deklaroj të hapur këtë mbledhje të rradhës të këshillit, të parë për vitin 2024.

Në këtë mbledhje do të shqyrtojmë dhe miratojmë mbi projektvendime të propozuara nga Kryetarja e Bashkisë, do informohemi mbi raportin 12 mujor të punës së Këshillit për vitin 2023, dhe raportin për sezonin turistik në Durrës, 2023, të cilin e shtymë për këtë mbledhje.

Materialet Ju janë vënë në dispozicion nga Sekretaria e Këshillit.

Ftoj sekretaren të procedoj me thirrjen e emrave të Këshilltarëve.

Dorina Milja: Fillojmë me prezencën.

Ardian Muka ... Prezent.....deri tek.... Florian Tahiri...Prezent.

34 Këshilltarë në sallë.

V.O... (*Hyn me vonesë Edlira Shemsi dhe Bledar Prizreni. Gjithsej 36 këshilltarë*)

Ani Dyrmishi: Meqë kuorumi është i pranishëm, vazhdojmë me mbledhjen.

Po kaloj në leximin e pikave të rendit të ditës. Sot për shqyrtim, miratim dhe raportim kemi 16 pika .

Pika 1.Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E KRITEREVE PËR FAMILJET NË NEVOJË QË DO TË TRAJTOHEN ME NDIHMË EKONOMIKE DERI NË 6 % TË FONDIT TË KUSHTËZUAR PËR BLOK-NDIHMËN EKONOMIKE SI DHE PËR ATO QË DO TË TRAJTOHEN ME FONDE TË BUXHETIT VENDOR
Pika 2.Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E SISTEMIT TË PIKËZIMIT PËR PËRZGJEDHJEN E FAMILJEVE QË KËRKOJNË TË PËRFITOJNË NGA PROGRAMET E STREHIMIT SOCIAL
Pika 3.Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E HARTËS SË PËRGJITHSHME TË PLAZHEVE TË LEJUARA KU DO TË USHTROHET VEPRIMTARIA SI STACION PLAZHI, PLAZHET PUBLIKE PËR VITIN 2024, SI DHE PLOTËSIMIN E SAJ ME ELEMENTËT E NEVOJSHËM LIDHUR ME STANDARTET E KËRKUARA NGA AKTET LIGJORE NË FUQI
Pika 4.Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E DISA SHITESAVE DHE NDRYSHIMEVE NË VENDIMET E KËSHILLIT BASHKIAK NR. 49, DATË 31.05.2022 PËRSA I PËRKET Z. KUJTIM CANI, NR. 35, DATË 31.03.2021 PËRSA I PËRKET Z. BLERIM DACI, NR. 187, DATË 22.12.2023 PËRSA I PËRKET ZNJ. FATBARDHA GJOLI, NR. 72, DATË 20.07.2020 PËRSA I PËRKET Z. ASTRIT JONUZ HOXHA, NR. 34, DATË 03.02.2023 PËRSA I PËRKET Z. ROMEO UZUNI DHE ZNJ. FATBARDHA UZUNI, NR. 107, DATË 19.10.2022 PËRSA I PËRKET Z. ARBEN LIMAN GJOKA, NR. 104, DATË 30.10.2020 PËRSA I PËRKET Z. AHMET RAMADAN XHURXHI
Pika 5.Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E NJË SHITESA NË ANEKSIN 1, BASHKALIDHUR VENDIMIT TË KËSHILLIT BASHKIAK NR. 62, DATË 17.03.2023 “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE NGA PROGRAMI I PROCESIT TË RINDËRTIMIT NË NJËSINË ADMINISTRATIVE NR.4, RRUGA “ALEKSANDËR GOGA”, PALLATIN NR.120, I DËMTUAR NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019”, I NDRYSHUAR
Pika 6.Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E DISA SHITESAVE TË VENDIMIT TË KËSHILLIT BASHKIAK NR. 34, DATË 09.05.2022, PËRSA I PËRKET LISTËS SË PËRFITUESVE NGA PROGRAMI I PROCESIT TË RINDËRTIMIT NË NJËSINË ADMINISTRATIVE NR.4, PALLATI NR.122, RRUGA “ALEKSANDËR GOGA”, I DËMTUAR NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019, I NDRYSHUAR

Pika 7.Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE NGA PROGRAMI I RINDËRTIMIT NË NJËSITË ADMINISTRATIVE NR. 2, 5, SUKTH, KATUND I RI, MANËZ DHE ISHËM BASHKIA DURRËS, QË DO TË PËRFITOJNË NGA PROGRAMI I PROCESIT TË RINDËRTIMIT PËR BANESAT INDIVIDUALE TË DËMTUARA NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019
Pika 8.Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E NGRITJES DHE FUNKSIONIMIT TË QENDRËS KOMUNITARE PËR SHËRBIME SOCIALE TË INTEGRUARA PËR FAMILJEN NË NJËSINË ADMINISTRATIVE SUKTH NGA PNUD TEK BASHKIA DURRËS
Pika 9.Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E NJË SHTESE NË ANEKSIN 1, BASHKALIDHUR VENDIMIT TË KËSHILLIT BASHKIAK NR. 189, DATË 22.12.2023 “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE NGA PROGRAMI I PROCESIT TË RINDËRTIMIT NË NJËSINË ADMINISTRATIVE NR.4, RRUGA “VRESHTAVE” PALLATI NR.8, I DËMTUAR NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019”
Pika 10.Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E DISA SHTESAVE NË ANEKSIN 1, BASHKALIDHUR VENDIMIT TË KËSHILLIT BASHKIAK NR. 190, DATË 22.12.2023 “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE NGA PROGRAMI I PROCESIT TË RINDËRTIMIT NË NJËSINË ADMINISTRATIVE NR.4, RRUGA “MUJO ULQINAKU”, PALLATI NR.72, I DËMTUAR NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019”
Pika 11.Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR EMËRTIMIN E TRI OBJEKTEVE ARSIMORE TË REJA NË NJËSINË ADMINISTRATIVE ISHËM DHE NË NJËSINË ADMINISTRATIVE MANËZ, NË BASHKINË DURRËS
Pika 12.Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E LISTËS SË TETËMBËDHJETË TË 10 SUBJEKTEVE PËRFITUESE, TË CILËT DO TË PËRFITOJNË MASËN E GRANTIT TË RINDËRTIMIT TË BANESAVE INDIVIDUALE TË DËMTUARA NGA TËRMETI I DATËS 26 NËNTOR 2019, SIPAS PROJEKTIT MODEL
Pika 13.Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E SHFUQIZIMIT TË SHKRONJËS (C) TË PIKËS 2, TË VKB-SË NR.164, DATË 23.12.2021, TË NDRYSHUAR
Pika 14.Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E SISTEMIMIT TË PËRKOHËSHËM TË FAMILJES SË Z.GJOKË PJETËR MRRUKU NË BANESËN ME NR.PASURIE 4/82+1-22, LAGJJA NR.12, DURRËS, NË PRONËSI TË BASHKISË DURRËS
Pika 15. Informim i këshilltarëve	RAPORTIM PËR SEZONIN TURISTIK NË DURRËS, 2023
Pika 16. Informim i këshilltarëve	RAPORT PËR PUNËN E KËSHILLIT TË BASHKISË PËR 12 - MUJORIN E VITIT 2023

Atëhere, përsa i përket rendit të ditës kemi ndonjë koment nga ana e këshilltarëve?

Komente nuk ka. Kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të rendit të ditës?

Kundra ... s'ka

Abstenim ...s'ka

Atëhere, me 35 vota pro miratohet rendi i ditës.

- Atëhere, përsa i përket **pikës 1**, i japim fjalën Komisionit të Barazisë Gjinore, Mirëqënies Sociale dhe Mosdiskriminimit znj.Edlira Shemsi.

Edlira Shemsi: Komisioni i Çështjeve Sociale, Mirëqënies Sociale pasi morëm në shqyrtim listën e familjeve që përfitojnë ndihmë ekonomike brënda fondit 6 % e miratoi atë, si dhe për kriteret për familjet e tjera që kërkojnë ndihmë brënda buxhetit vendor, kjo listë është miratuar plotësisht. Ja paraqesim për miratim këshillit.

Ani Dyrmishi: Faleminderit.

Komente përsa i përket pikës 1 kemi nga ana e këshilltarëve?

Nuk ka. Kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 1 të rendit të ditës?

Kundra? ...Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka.

Atëhere, me 35 vota pro miratohet pika 1 e rendit të ditës.

- Kalojmë **në projektvendimin për pikën 2**. I japim fjalën Komisionit të Strehimit dhe Shërbimeve Publike, zonja Joniada Musaraj.

Joniada Musaraj: Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike e miratoi pikën 2 dhe propozon të kaloj në këshill. Faleminderit.

Ani Dyrmishi: Komente përsa i përket pikës 2 kemi? ...

Po, zoti Muka.

Ardian Muka: Mirëdita.

Edhe dje në Komision, unë mora pjesë në Komision meqenëse kishim një problem të ngritur nga disa qytetar në fakt, diskutohet për një pjesë qytetarësh që janë dhe të moshuar dhe përsa i takon, ato marrin pension minimal, ndërkohë që në sistemin e pikëzimit klasifikohen në fillim e pastaj deklasifikohen, pasi nuk arrijnë pasi për shkak të pensionit ato nuk arrijnë të paguajnë pjesën e qerasë. Unë vetë isha i paqartë dhe propozova që të ishte mundësia e një garantori. Por nga ana e komisionit u sqarua që është kjo mundësi, por meqë nuk plotësohet, meqë nuk plotësohet direkt nga sistemi e-albania. Duke patur që kemi një shtresë që unë them që nuk arrijnë ta perceptojnë këtë problem do të propozoja që në njësitë administrative të ishte e mundur, të bëhet e mundur që nga ana e inxhinjerit apo urbanistit kush është te njësia administrative t'i asistonte në formulimin dhe plotësimin e kësaj faze. Pra dikush që ka të birin që mund t'i nisi 100 , 200 euro në muaj, por

që s'mund ta demostrojë dot, pasi kanë vetëm pjesën e pensionit të tyre. Tek e-albania është mundësia që ata ta deklarojnë. Këto njerëz mos të deklasifikohen pra, mos të quhen të pamundur të papërshtatshëm me marr strehim, ndërkohë që është kjo mundësi, të shikohet kjo mundësi. Pra të shihet mundësia nga ana e bashkisë se si mund të bëhet ky asistim. Faleminderit.

Ani Dyrmishi: Faleminderit.

Besoj se bashkia mund ta ketë në konsideratë këtë propozim.

Tjetër koment?

Edlira Shemsi: Nga kjo që tha z.Muka, ne e diskutuam dhe në komision, për qytetarët që janë me asistencë sociale apo janë me kempe, janë invalid, janë në kushte pa strehim, përveç aplikimit që duhet bërë në bazë të pikëzimit që duhet bërë tek e-albania, ne kërkuam që të asistoheshin dhe nga punonjësit e bashkisë për të bërë këto aplikime, por dhe një fond shtesë për këta njerëz që realisht janë në nevojë pasi marrin një pension të vogël prej 10 mijë lekë të rejash, dhe që vërtetë është pikëzimi që është bërë nga e-albania, por të kenë dhe suport nga bashkia. Në fakt në komision, përfaqësuesja e bashkisë shprehu plotësisht atë përkushtimin që këta të paraqiten dhe mund ta bëjnë aplikimin këtu, t'i ndihmojmë dhe për raste të veçanta t'i kalojmë dhe në këshillin bashkiak. Këtë kërkuam. Mendoj që do të kemi mirëkuptim. Faleminderit.

Ani Dyrmishi: Faleminderit.

Koment tjetër?... Nuk ka. Atëhere, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 2 të rendit të ditës?

Kundra? ...

Abstenim? ... Nuk ka.

Atëhere, me 36 vota pro, miratohet pika 2 e rendit të ditës.

- Kalojmë **në pikën 3**. I japim fjalën Komisionit të Politikave të Zhvillimit të Turizmit, zj.Alketa Ngjeçi

Alketa Ngjeçi: Pas mbledhjes së djeshme Komisioni i Turizmit ra dakort që pika 3 të kaloj për miratim në këshill.

Ani Dyrmishi: Faleminderit.

Komisioni i Zhvillimit Urban dhe Përdorimit të Tokës, z. Muka.

Dorina Milja : Jonada nuk ishte në komision.

Ani Dyrmishi: Ok.

Ardian Muka : Pas shqyrtimit edhe Komisioni jonë është dakort dhe të kaloj në seancë.

Ani Dyrmishi: Faleminderit.

Komente përsa i përket pikës 3?

Po.

Ardian Muka: Ne në komision e diskutuam, një nga komentet që unë do të bëja them në lidhje me metodologjinë që është përdorur për parcelizimin e sipërfaqeve të plazheve, që do të jepen në përdorim ndaj qytetarëve dhe bizneseve, mendoj që në shpërndarje baza ligjore e cila është 70 me 30 %, pra 70 % e plazheve duhet të jenë në funksion të bizneseve dhe 30 % do të jetë në dispozicion të publikes.

Fakikisht në bashkinë e Durrësit sipas raportimit nga ana e bashkisë neve gjatë gjithë kësaj periudhe kemi qenë në nivelin 40 me 60, pra 60 % pjesa private dhe rreth 40 % pjesa publike dhe ajo ç'ka na propozohet në këtë plan është 42 % do të jetë pjesë publike dhe 58 % është private. Problematika thashë ka lidhje me metodologjinë, mënyra si janë parcelizuar zonat len pak pjesë për plazhet publike, por problemi është se gjatë gjithë vijës bregdetare i kemi të kombinuar pjesën e biznesit me pjesën rezidenciale. Pra është e drejtë që ai që ka një hotel në vijën e parë të ketë akses patjetër në vijën e rërës, por dhe rezidentët e pretendojnë këtë që ta shfrytëzojnë pjesën e detit. Ndërkohë që pjesët sipas metodologjisë që propozohet, pjesët janë dhënë të shpërndara, janë caktuar përgjatë vijës së plazhit disa parcela publike, por dikush që e ka shtëpinë te Teuta duhet ta bëjë plazhin në Iliria, tek pjesa që është caktuar publike. Për këtë ne sugjerojmë nuk e dimë sa mund të bëhet pjesë e këtij projekti, po ndofta mund të shihet dhe për projektet në vitet e ardhshme, një zgjidhje që do të ishte për bashkinë e vështirë për tu administruar, por thamë vija e parë të parcelizohet kundrejt sipërfaqeve për bizneset dhe të ketë mundësi që gjatë gjithë vijës së ujit brezin fundor, pra pasi të ketë marrë biznesi t'i jepet mundësia dhe plazhit publik. Pra mos të jetë i parcelizuar siç është tani një parcelë në plazhin Teuta apo një në Apollonia apo një në Iliria, por të jetë gjatë gjithë vijës bregdetar, në pjesën fundore, pra një apo dy rreshta të jenë në funksion të publikut. Kjo do të bënte që pjesa rezidenciale do të dilte përpara shtëpisë në zonën publike që mos merrnin çadra me qera dhe në mëndimin tim do ishte më demokratike në mënyrën e shpërndarjes. Kjo do të bënte që dhe raporti do të shkonte në mënyrë ideale drejt 70, 30-s për pjesën publike. Po kjo është një pjesë publike që nuk shfrytëzohet mirë, ndërkohë që ne e humbin, flas për bashkinë, pra bashkia nuk arrin të vjeli taksa, mos shkojmë në nivelin e 42-shit, po ne të shkojmë në nivelin e 30, 70-s. Kjo do të bënte më shumë taksa të mbledhura nga ana e bashkisë. Në mënyrë automatike përkthehet më shumë shërbime për qytetarët.

Përsa i takon pjesës së infrastrukturës, natyrisht për infrastrukturën flas për zonën e plazhit duke qenë një vijë mjaft e gjatë bregdetare, në ato zona, të cilat për momentin nuk mbulohen me infrastrukturë, nuk kanë rrugë, nuk kanë ujë e pijshëm nuk kanë sitemin e kanalizimit të ujrave të zeza do propozoj ndryshimin të paktën me një tarifë tjetër. Mos ishte e njëjta tarifë pasi ato do t'i kryejnë këto investime vet. Pra kush do t'i marrë ato parcela që janë të interesuar, flas për bizneset që do të paguajnë taksën për pjesën plazhit duhet ose t'i ulim ose bashkia duhet të tentojë të çoj atje rrugën ujë e shërbimet, flas për zonën e Kallmit ku ka shumë plazhe që shkojnë qytetarët Durrsak. Ato njëzë ujë e blejnë me makinë, i çojnë me mjetet e tyre, rruga është ajo që është, sistemi i kanalizimeve është me gropa septike. Në këtë rast shihet mundësia që këto të trajtohen ndryshe nga pjesa e gjirit të Lalëzit apo plazhit i madh. Po ashtu dhe zona e Porto-Romanos, e cila dhe ajo nuk është e pajisur me infrastrukturën e duhur.

Këto kisha. Besoj do të merren parasysh thashë që në këtë moment jemi besoj, që jemi në kohë, por nuk e di sa mund të arrijmë t'i traskiptojmë këto veprimesh.

Ani Dyrmishi: Faleminderit. Z. Muka.

Koment tjetër?

Edlira Shemsi: Në vazhdimësi të asaj që tha z. Muka do flas për vijën bregdetare brënda qytetit. Plazhe që historikisht ka qënë ato plazhe të durrsakve të vjetër që tashmë janë në moshë të tretë. Ne në herën e kaluar kemi parë që ata që historikisht kanë dashë të shkojnë me çadër e peshqirë për tu shtrirë në rërë shkonin tek gurët e te betoni, pasi gjithë vija bregdetare ishte e zënë nga privatët. Këta janë në një moshë që nuk mund të shkojnë, me vërte që kemi një vijë bregdetare goxha të gjërë, por nuk mund të shkojnë shumë larg qytetit për shak të moshës që kanë. Kështu që brënda plazheve të qytetit duhet patjetër të lehet plazhe publike sidomos për këtë moshën që nuk merr dot makinën për me shku nëpër plazhet e tjera. Dhe ne na vinë foto kur ato ishin duke bërë plazh aty ke betoni, te gurët. Mendoj që jemi në kohë siç tha z. Muka që të marrim masa që kjo kategori që i përket moshës së tretë dhe që me vërte duhet me e respektu se e kanë dashë gjithmonë detin, se janë ato durrsakët e vjetër që e kanë bërë plazhin nga Sfinksit deri te Currilat tu lehet hapsira, pasi ka qënë aq e pakët hapsira për to një rrip i vogël ka qënë në një zonë te Currilat dhe gjitha zona tjetër ka qënë e zënë nga privatët.

Mendoj që jemi në kohë që ta realizojmë këtë, t'i lihet kësaj kategorie, durrsakëve të një moshe që nuk marrin dot çadrën e nuk marrin dot autobuzin e makinën me shku më larg e të lihen këto plazhe afër qytetit ku ka akses dhe të shkojnë ta bëjnë dhe ata plazhin. Këtë do të sugjeroja.

Ani Dyrmishi: Faleminderit.

Po Kasa.

Flutura Kasa: Me gjithë respektin për kolegët, Ju lutem bëjini i çik më të përmbledhura këto se sinqerisht janë 16 pika, e me bo gjithë këtë koment. Janë plotësisht të drejta ato që thoni, po i çik më konçiz se ...

Edlira Shemsi: Më konçiz se kaq zonja Flutura s'mendoj se ka.

Flutura Kasa: Po i çik më ashtu o burrë se janë 16 pika.

Ani Dyrmishi: Atëhere koment tjetër?

Atëherë nuk ka. Kalojmë votim.

Dorina Milja : Është Rolant.

Ani Dyrmishi: Po, z. Xhelili, më fal.

Rolant Xhelili : Na e preu çik Flutura tashi se tha konçiz. Po hajde boje konçizin.

Ke të drejtë në parim, por ku ka problem pranohet çdo lloj propozimi. Mendoj që janë propozime, që 2 anëtarët e këshillit që i ngritën, mund të shërbejnë si një ide e mirë për ata institucione që merren me këtë punë për t'i studiuar për periudhat në vazhdim.

Historiku i plazhit jemi të gjithë këtu shumica durrsak e dimë që, nga 100 % publik u kthye me ndryshime 100 % privat dhe tani është një masë shumë e mirë e qeverisë dhe institucioneve vendore, bashkisë, që vendosi një parim të ndarjes në përqindje 60/40, 70/30, e të tilla më radhë. Te kjo pjesë themi që përpjekja e bashkisë është që ky raport të sigurohet. Pastaj e ka të vështirë ai nga Teuta të shkoj te plazhi publik që është në Hekurudha nuk e ka të vështirë. Ne kemi shku nga Durrësi historikisht dhe e kemi bo plazhin Iliria, edhe Muka edhe një pjesë e mirë e jona e di e kemi bo o në Hekurudha o në Iliria. Gjithë problemi sot është që 70/30 të jetë funksionale dhe ai 30-çi publikut me kontributin e institucionit, bashkisë, ndërmarrjes përkatëse të jetë në nivel të mirë, sepse edhe qytetari i thjeshtë edhe në moshë ka dëshirë që kushtet t'i ketë të tilla që edhe plazhin ta bëj mirë, edhe pjesa e ranës të jetë cilësore ajo pjesë që bie të jetë plazh publik, edhe shërbimi aty nga institucionet të jetë i tillë që të ndikojë pozitivisht për shtimin e njerëzve që shkojnë aty. Dhe në propozimet e kolegëve të shifet mundësia e ndonji institucioni që merret me këtë punë të shikohen, sepse ajo ndarja me vija po të më pyesësh mu si konsumator i vjetër i plazhit nuk më pëlqen, të më lesh tëk vija e tretë si plazh publik dhe vija parë të jenë ato shezllonët, dhe ato çadrat e të gjitha me radhë nuk më duket pozitive. Megjithatë kjo është shije personale nuk ka rëndësi. Janë propozime që mund të rishikohen edhe nga institucioni jonë, nga bashkia, si propozim i këshilli bashkiak në raport me gjithë ato institucione që merren me mbrojtjen e bregdetit dhe në periudhën në vazhdim të ketë përmirësim, ruajtje të përqindjeve që përcaktohen dhe përmirësim gjithnjë e më mirë të kushteve për plazhet publike. Faleminderit.

Ani Dyrmishi: Faleminderit z. Xhelili.

Atëhere koment tjetër nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 3 të rendit të ditës?

Kundra? ..s'ka.

Abstenim? ... s'ka.

Atëhere me 36 vota pro, miratohet pika 3 e rendit të ditës

- Kalojmë në projektvendimin **për pikën 4**. I japim fjalën Komisionit të Rregullores dhe Çështjeve Juridike, zonjës Rroshi.

Alneida Rroshi: Faleminderit Kryetar.

Për pikën 4 komisioni ynë propozon për ta kaluar në votim.

Ani Dyrmishi: Faleminderit.

Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike, zonja Musaraj.

Joniada Musaraj: Edhe komisioni ynë votoi me unanimitet dhe e propozon për ta kaluar në këshill.

Ani Dyrmishi: Faleminderit.

Komente përsa i përket pikës 4 kemi?

Dritan Burgija : Po

Ani Dyrmishi: Po z. Burgija.

Dritan Burgija: Ja ku jemi prap tek problemet e rindërtimit. Përpara se të bëj koment për pikën 4 do ngrej një 2 shqetësime në lidhje me aktivitetin e bashkisë dhe kryetares së bashkisë. Nisur nga refuzimi juaj për ngritjen e Komisionit Hetimor përsa i përket çështjes së rindërtimit që nga ne u kërkuar me forcë, nisur nga përgjigja e prefektit, për mu qesharake, që e gjente të ligjshme dhe duke zbatu rregulloren refuzimin tonë. Duke u nis dhe nga ndërhyjet e disa kolegëve këtu që thonin: Pse keni zgjedh këtë rrugë për Komision Hetimor ? Mund të kishit zgjedh rrugë, të bënit kërkesë në rrugë shkresore që të merrnit informacion për çdo gjë. Nga data 3.11, në fakt po marr datën e parë kemi depozitu në bashki të Durrësit që bëjnë 2 muaj sot, kanë kalu 2 muaj, disa kërkesa për informacion dhe prej 2 muajsh presim dhe nuk kemi asnjë përgjigje. Kemi bërë kërkesë për stacionin e trenit, për ndërtimin e stacionit të trenit, ku na u kërku këtu...

Ardian Muka : Parkimi

Dritan Burgija:...po parkimi stacioni të trenit, na u kërku këtu që një parcelë atje tu vente në dispozicion të bashkisë dhe me të drejtë kërkuam nëse kishte leje ndërtimi a s'kishte leje ndërtimi, e kërkuam këtu në sallë. Me datë 3.11 kam bërë kërkesë me shkrim dhe nuk kam akoma përgjigje. Pastaj kemi kërkuar në lidhje më mbetjet. Janë në protokoll të gjitha. I kam dhe fotokopje, nëse nuk ju ka rënë në dorë jua vej në dispozicion qoftë juve, qoftë mediave. Në lidhje me mbetjet me datë 15.12.2023, nuk kemi akoma asnjë informacion. Kam kërku në lidhje për, në lidhje me çështjet e rindërtimit, kërkesë specifike për Rajonin 4, listën e personave që janë trajtuar me, që kanë qënë DS1, DS2 që i ka ndryshu statusi, as sot nuk e kam këtë informacion. Kam kërku dhe listën e personave që kanë përfitu nga procesi i rindërtimit dhe kanë marrë para për nivelin DS3, as këtë nuk e kemi.

Tani kaloj te pika 4, që e gjej problematike në fakt, nuk kam asgjë me emra të përveçëm për njerëzit që përfitojnë aty se e kemi thënë që nga dita e parë e këtij këshilli që jemi në shërbim të qytetarëve dhe shpresojmë që të marrin zgjidhje për problemet e tyre domethënë. Po përmend një rast, po pa përmend emra, po shpjegoj fenomenin. Është një familje në Sukth që me datë 5.2.2020, 3 muaj pas tërmetit në çertifikatë familjare, përbëhet familja nga 2 persona, me datë 25.09, janë vërtetime të çuara nga njësia administrative, me 25.09.2023 e njëjta familje përbëhet nga 4 persona dhe me 07.12.2023 e njëjta familje me 6 persona. Jemi te pika 4 ku këto persona duke rrit numrin e banorëve përfitojnë diçka më shumë ke trajtimi nga, nga procesi i rindërtimit. Kam relacionin këtu, i referohem relacionit.

Ani Dyrmishi : Problemi o Tan...

Dritan Burgija : Ja një sekond ta maroj e pastaj...

Ani Dyrmishi: Jo, për këtë problematik, për sqarim se dhe unë jetoj në shtëpi me momën time jemi trung më vete familjar.

Dritan Burgija: E pranoj dhe shpjegimin...

Ani Dyrmishi: Ka raste që jetojnë me një shpi, por janë ndarë për probleme të ndryshme.

Dritan Burgija : Në përgjithësi të gjitha rastet janë të tilla ku në ditën që ka ndodh tërmeti kanë qenë më pak pjestarë në familje, pastaj me vërtetim nga, domethënë ja keni lënë në dorë drejtuesit të njësisë administrative ta administrojë këtë punë.

E di kush është shqetësimi im? Shqetësimi im nuk është që këta banorë po përfitojnë. Këta përfitojnë se është e drejtë e tyre, shqetësimi im është se ne jetojmë në një qytet shumë të vogël, njëfemi të gjithë me njëri tjetrin dhe po vijnë e na thonë nga institucionet bankare që po vijnë njerëz kërkojnë kredi 5000 euro sepse kanë hall duhet të paguajnë se s'bën që të përfitojnë një dhomë më shumë. E dimë shumë mirë që ata që e bëjnë veprimin ata janë që flasin mrapa. Nesër mos ju duket çudi që këta persona do ju dalin dëshmitar pasi ta kenë kry hallin e vet .

Ani Dyrmishi: Ato në fakt duhet ta bëjnë kallzim që sot po e kanë kry.

Dritan Burgija: Po mirë mo mirë, po tashi është momenti që të kryejnë hallin e shtëpisë njëherë. Kaq kisha për momentin. Faleminderit.

Ani Dyrmishi: Koment ka tjetër?

Nuk ka. Kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 4 të rendit të ditës?

Dritan Burgija: Do abstenojmë.

Ani Dyrmishi: Kundra? ...

Abstënim?.....

1,2,3,4,5,6,7.....

Ngrejeni dhe një herë abstënim t'i numërojmë.

9 abstënim.

27 pro.

Me 27 vota pro dhe 9 abstënim miratohet dhe pika 4.

- Kalojmë në projektvendimin **për pikën 5**. I japim fjalën Komisionit të Rregullores dhe Çështjeve Juridike, zonjës Rroshi.

Alneida Rroshi: Edhe për pikën 5, propozojmë për ta kaluar në votim.

Ani Dyrmishi: Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike, zonja Musaraj.

Joniada Musaraj: Edhe komisioni ynë është dakort ta kaloj këtë pikë.

Ani Dyrmishi: Faleminderit.

Komente për pikën 5?

Komente nuk ka. Kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 5 të rendit të ditës? ...

Kundra? ...

Abstenim? ... Nuk ka.

Atëhere, me 36 vota pro miratohet pika 5.

- Kalojmë në **pikën 6**. I japim fjalën Komisionit të Rregullores dhe Çështjeve Juridike, zonjës Rroshi.

Alneida Rroshi: Pas shqyrtimit të pikës 6, propozojmë për ta kaluar në votim.

Ani Dyrmishi: Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike, zonja Musaraj.

Joniada Musaraj: Edhe komisioni ynë propozon ta kaloj në votim.

Ani Dyrmishi: Komente për pikën 6, ka?

Komente nuk ka. Kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 6 të rendit të ditës? ...

Kundra? ...

Abstenim? ... Nuk ka.

Atëhere, me 36 vota pro miratohet pika 6.

- Kalojmë në **pikën 7**. Komisioni i Rregullores dhe Çështjeve Juridike, zonjës Rroshi.

Alneida Rroshi: Pas shqyrtimit të pikës 7, propozojmë për ta kaluar në votim.

Ani Dyrmishi: Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike, zonja Musaraj.

Joniada Musaraj: Edhe për pikën 7 jemi dakort ta kalojmë në votim.

Ani Dyrmishi: Faleminderit.

Komente për pikën 7 kemi?

Komente nuk ka. Kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 7 të rendit të ditës? ...

Kundra? ...

Abstenim? ... Nuk ka.

Atëhere, me 36 vota pro miratohet pika 7.

- Kalojmë në **pikën 8**. I japim fjalën Komisionit të Barazisë Gjinore, Mirëqënies Sociale dhe Mosdiskriminimit znj. Shemsi.

Edlira Shemsi: Komisioni i Çështjeve Sociale dhe Mosdiskriminimit pasi morëm në shqyrtim pikën 8 që ka të bëjë me transferimin e një qendër komunitare që deri me tashmë ka qënë finacuar dhe asistuar nga programet e PNUD-it në funksion të bashkisë së Durrësit, në administrim të bashkisë së Durrësit. Punonjësit do vazhdojnë të jenë po ato, bashkia do të japë pagat dhe do të vazhdojë akoma asistencë e PNUD-it, asistencë financiare, asistencë, e do për seanca psikologjike apo gjëra të tjera apo mundësi strehimi për personat në nevojë në këtë qendër, po vetëm punonjësit do kalojnë me paga nga bashkia e Durrësit dhe qendra tashmë do të asistohet nga bashkia e Durrësit. Ne e miratim dhe ja paraqisim këshillit për miratim.

Ani Dyrmishi: Faleminderit.

Komente përsa i përket pikës 8, kemi?

Komente nuk ka. Kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 8 të rendit të ditës?

Kundra? ...

Abstenim? ... Nuk ka.

Atëhere, me 36 vota pro, miratohet.

- Kalojmë në **pikën 9**. I japim fjalën Komisionit të Rregullores dhe Çështjeve Juridike, zonjës Rroshi.

Alneida Rroshi: Pas shqyrtimit për pikën 9, propozojmë për ta kaluar në votim.

Ani Dyrmishi: Faleminderit.

Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike, zonja Musaraj.

Joniada Musaraj: Pika 9 u votua në komision në unanimitet dhe kalon për këshill bashkiak.

Ani Dyrmishi: Faleminderit.

Komente për pikën 9, kemi?

Nuk ka. Kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 9 të rendit të ditës?

Kundra? ...

Abstenim?... Nuk ka.

Me 36 vota pro, miratohet dhe pika 9.

- Kalojmë në **pikën 10**. I japim fjalën Komisionit të Rregullores dhe Çështjeve Juridike, zonjës Rroshi.

Alneida Rroshi: Edhe për pikën 10, ramë dakord për ta kaluar në votim.

Ani Dyrmishi: Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike, zonja Musaraj.

Joniada Musaraj: Edhe komisioni ynë është dakort për ta kaluar këtë pikë.

Ani Dyrmishi: Faleminderit.

Përsa i përket pikës 10, kemi komente nga ana e këshilltarëve?

Edlira Shemsi : Në Komisionin e Strehimit ngritëm dhe njëherë problemin e shumë herë të ngritur këtu të bonuseve. Përfaqësuesja e bashkisë na dha përsëri të njëjtën përgjigje, që nga marsi qeveria nuk ka caktuar fonde për bonuse. Dhe një pjesë e qytetarëve paguajnë bonuse nga xhepi ose ka rast që futen dhe në shtëpitë e dëmtuara, pasi nuk kanë mundësi financiare për të paguar më qeratë. Vazhdojmë të ngremë shqetësimin e ngritur nga shumë qytetarë : Çfarë po bëhet me bonuset? Sepse shumë nuk kanë mundësi ta paguajnë atë dhe po futen në shtëpitë e dëmtuara. Faleminderit.

Ani Dyrmishi : Koment tjetër?

Ardian Muka : Një koment nga ana e bashkisë mund të jepet? Për pjesën e bonuseve pse nuk paguhet.

Ani Dyrmishi : E kanë bërë 4 herë këtë pyetje.

Ardian Muka: Të përgjigjet po me të njëjtën.

Gentian Kallmi: Meqë nuk është tek rendi ditës, për ta dhënë më poshtë me temën e radhës.

Edlira Shemsi: Jo qeveria nuk ka dhënë fonde dhe përgjigja është shteruese. Por në të njëjtën kohë janë qytetarë të bashkisë Durrësit, po bashkia ndjen përgjegjësi për këta qytetar apo jo? Kjo është pyetja dhe presim përgjigje.

Dritan Burgjia: A mund ta jap unë një përgjigje. Kush bëri pyetje dhe do një përgjigje, përgjigjen do ta marri shumë pak muaj para se të vi koha e zgjedhjeve.

Ani Dyrmishi : Faleminderit.

Koment tjetër?

Nuk ka. Kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 10 të rendit të ditës?

Kundra? ...

Abstenim? ... Nuk ka.

Me 36 vota pro, miratohet dhe pika 10.

- Kalojmë në **pikën 11**. I japim fjalën Komisionit të Kulturës, Arsimit, Rinisë, Sporteve, Komuniteteve Fetare dhe Titujve të Nderit, znj. Denisa Luarasi

Denisa Luarasi : Edhe për pikën 11 komisioni ynë ra dakort që të kaloj për votim.

Ani Dyrmishi: Faleminderit.

Komente për pikën 11, kemi?

Nuk ka. Kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 11 të rendit të ditës?

Kundra? ...

Abstenim? ... Nuk ka.

Atëhere me 36 pro, miratohet pika 11.

- Kalojmë **në pikën 12**. I japim fjalën Komisionit të Rregullores dhe Çështjeve Juridike, zonjës Rroshi.

Alneida Rroshi: Pas shqyrtimit për pikën 12, jemi dakord për ta kaluar në votim.

Ani Dyrmishi: Faleminderit.

Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike, zonja Musaraj.

Joniada Musaraj: Edhe komisioni ynë propozon për ta kaluar në votim.

Ani Dyrmishi: Faleminderit.

Komente për pikën 12, ka?

Atëhere, komente nuk ka. Kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 12 të rendit të ditës?

Kundra?Nuk ka.

Abstenim? ... Nuk ka.

Atëhere, me 36 vota pro, miratohet dhe pika 12.

- Kalojmë në **pikën 13**. I japim fjalën Komisionit të Pronave Publike, Transportit dhe Trafikut Rrugor z. Hekuran Markola.

Hekuran Markola: Faleminderit Kryetar.

Komisioni i Pronave Publike, Transportit dhe Trafikut Rrugor pasi dëgjoji nga përfaqëuesi i bashkisë arsyen pse tërhiqet pika 3, në unanimitet e votoi dhe e kalon për votim në këshill bashkiak.

Ani Dyrmishi: Faleminderit z. Markola.

Komente përsa i përket pikës 13?

Nuk ka. Kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 13 të rendit të ditës?

Kundra? ...

Abstenim? ...Nuk ka

Atëhere me 36 vota pro, miratohet dhe pika 13.

- Kalojmë në **pikën 14**. I japim fjalën Komisionit të Strehimit dhe Shërbimeve Publike, zonjës Musaraj.

Joniada Musaraj: Komisioni ynë e miratoi pikën 14 dhe e propozon për votim. Faleminderit.

Ani Dyrmishi: Faleminderit.

Komente përsa i përket pikës 14?

Nuk ka. Kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 14 të rendit të ditës?

Kundra? ...

Abstenim? ... Nuk ka.

Atëhere me 36 vota pro, miratohet dhe pika 14.

- Kalojmë **te pika 15**, i japim fjalën për “Raportim për sezonin turistik në Durrës për vitin 2023” zonjës Floreta Kërtusha.

Floreta Kërtusha (*Përgjegjëse pranë Drejtorisë Turizmit*): Të nderuar anëtarë të Këshillit Bashkiak përshëndetje!

Do mundohem të jem sa më konçize.... (Lexoi raportin dorëzuar pranë Sekretariatit të Këshillit me nr.prot 1239, datë 25.01.2024).

Ani Dyrmishi : Atëherë pyetje përsa i përket raportimit?

Po z. Muka.

Ardian Muka: Faleminderit për raportimin.

Kërkova nëpër dokumente duke qënë se kam qënë pjesë e këshillit dhe në vitin 2015, pashë që në këtë kohë kanë qënë 7 milion e 500 mijë, pra 75 milion lekë të vjetra që u mblidhnin nga taksa e turistëve, 100 lekë-shi i famshëm apo 1 euro , ndërkohë që raportohet se kemi arritur në 56 milion e 747 mijë , pra rreth 567 milion lekë të vjetra. Hodha 2 numra! Hodha 2 numra dhe shoh që nëse këtë shifër e pjestojmë më 1 euro janë rreth 472.000 netë qëndrimi. Duke marrë parasysh INSTAT, i cili thotë që për vitin 2022, nuk kemi nxjerrë referencën për 2023, një turist në Shqipëri ka qëndruar 2.56 netë, i bie që në Durrës kanë qënë deklaruar pas shumës që është arkëtuar 184.725 turistë. Po marrim një periudhë nuk po e shtrimë për 12 muaj se nuk do bënte sens shumë, po flasim për një 3 muaj-sh që jemi në periudhën e sezonit veror, për 90 ditë kemi 61.575 turistë në muaj që kanë flejtë në Durrës, për 30 ditë kemi mesatare në natë 2052 turistë. Duke konsideruar raportin që na referoi që Durrësi ka 11.528 shtretër të deklaruar, shfytëzimi për periudhën e pikut flasim, e kemi pjestuar për pikun, jo për 12 muaj, pra 3 muaj është diçka më pak se 20 %.

Pra natyrisht puna e bashkisë në këto 10 vite e ka rritur performancën, flas nga 75 milion lekë të vjetra kemi arritur në 567 milion lekë të vjetra, por nga ana tjetër duhet të kuptojmë që nuk jemi aty ku duhet. Durrësi fal zoti për mundësitë që i ka dhënë për pjesën e detit, për pjesën e arkeologjisë, për atë që është trashëgimia kulturore, duhet të ishim në nivele komplet të tjera them unë. Me 20 % unë nuk e di si arrijmë realisht, duke heq pjesën e bizneseve të mëdhaja dhe për ato me hotele të vogla se di se si ja dalin. Këtu do ishte pjesa e bashkisë, pjesa promovuese për turizmin. Durrësi nga perla e Adriatikut që kanë qënë, tashi në Shqipëri jemi në vendin e fundit, duke patur parasysh që trafiku është postuar drejt jugut, kjo falë edhe të një politike të gabuar,

besoj që qeveria ka bërë, sepse plazhin e Durrësit e konsiderojnë si masiv, ndërkohë që plazh elitari është plazhi i Vlorës dhe plazhi i Sarandës. Megjithatë ne thashë, duhet të përqipemi si Këshill që me politikat që duhet të ndërtojmë për pjesën e turizmit, të jemi më, duhet të krijojmë më shumë facilitete, të krijojmë më shumë mundësi në mënyrë që Durrësi të vihet aty ku i takon. Ju faleminderit.

Ani Dyrmishi: Faleminderit z. Muka.

- Atëherë kalojmë te **pika 16**. Për të mos u zgatur po e shpreh në vija të përgjithshme, pasi më të detajur e keni lexuar, i cili do të bëhet dhe publik në faqen zyrtare të Këshillit, kështu që do të jetë i aksesueshëm dhe për publikun:

Të nderuar këshilltarë !

Ky raport mbahet në përmbushje të detyrimit të parashikuar në Rregulloren e Funkcionimit të Këshillit të Bashkisë Durrës, miratuar me Vendim nr.25, datë 29.04.2020. Në këtë raport jepen të dhëna të detajuara mbi mbledhjet e këshillit, mbledhjet e komisioneve, vendimet e marra dhe konsultimet publike.

Këshilli Bashkiak, si organi përfaqësues dhe vendimmarrës i qeverisë bashkiake, i ushtron përgjegjësitë e tij qeverisëse, duke respektuar parimet e demokracisë vendore, transparencës qeverisëse, ligjshmërisë, duke përdorur me ekonomi, efikasitet dhe efektivitet burimet njerëzore, financiare, fizike e natyrore si dhe teknologjike të Bashkisë.

Veprimtaria e Këshillit Bashkiak Durrës mbështetet në zbatimin e detyrimeve që burojnë nga ligjet, aktet nënligjore në zbatim të tyre si dhe rregulloret e miratuara nga vet këshilli bashkiak.

Ky vit ka qënë dhe vit zgjedhesh për pushtetin vendor dhe me datë 21 qershor 2023 u mandatua këshilli i ri i dalë nga zgjedhjet vendore të datës 14 maj 2023.

Për periudhën janar–dhjetor 2023, janë marrë 196 vendime gjithsej në Këshillin Bashkiak.

Nga karakteri i vendimeve mund t'i ndajmë në:

1. për probleme financiare - 20 vendime
2. për probleme sociale - 13 vendime
3. për infrastrukturën dhe strehimin - 115 vendime
4. për problemet urbane dhe asetet - 18 vendime
5. për emergjencat civile - 4 vendime
6. për probleme të arsimit kulturës - 8 vendime
7. të ndryshme - 18 vendime

Numrin më të madh të vendimeve e përbëjnë vendimet që kanë të bëjnë me infrastrukturën dhe strehimin, konkretisht për familjet përfituese në kuadër të procesit të rindërtimit, ku janë marrë vetëm për tërmetin 107 vendime.

Vlen për tu theksuar se të gjitha vendimet e Këshillit Bashkiak Durrës kanë qënë konform ligjeve dhe vendimeve të Këshillit të Ministrave. Për vendimet e marra nga ky Këshill për 12 mujorin e vitit 2023 institucioni i Prefektit të Qarkut Durrës është shprehur pozitivisht për shprehjen e ligjshmërisë ndaj tyre për të gjitha vendimet e marra.

Këshilli gjatë kësaj periudhe ka qënë aktiv, duke mbajtur 12 mbledhje të radhës, 6 mbledhje jashtëradhe dhe nuk ka mbajtur asnjë mbledhje të jashtëzakondshme. Vlen për tu përmendur se

pjesmarrja e këshilltarëve ka qënë më aktive në procesin e vendimmarrjes në mbledhjet plenare në 6 mujorin e dytë.

Është ngritur për këtë legjislaturë të re Komisioni i Teknologjisë dhe Inovacionit si Komisioni i Përhershëm, propozuar gjatë seancës dëgjimore nga një OJF.

Komisionet e përhershme të këshillit për periudhën 12-mujore kanë mbajtur 85 mbledhje. Gjatë periudhës janar-maj 2023 Komisionet i kanë mbajtur mbledhjet e tyre me mjete të komunikimit elektronik, ndërsa për periudhën qeshor-dhjetor 2023 mbledhjet janë mbajtur në Sallën e Këshillit apo Zyrën e Sekretarisë së Këshillit. Pjesmarrja e këshilltarëve ka qënë më aktive në ato mbledhje të organizuara me mjete të komunikimit elektronik. Gjatë 12 mujorit janë dorëzuar 103 raporte apo povesverbale të mbajtura nga këto komisione.

Është përditsuar faqa online e Këshillit Bashkiak me informacione për publikun.

Këshilli duke ju përshtatur dhe risive të teknologjisë për përcimin sa më shpejt të njoftimeve apo komunikimit direkt me qytetarët ka dhe faqen e tij në rrjetin social facebook në të cilin bën njoftimet për mbledhjet e tij si dhe merr vërejtje, ankesa, kërkesa e sygjjerime nga qytetarë të ndryshëm.

Mbetet si detyrë mjaft e rëndësishme për të ardhmen gjetja e mënyrave dhe formave të tjera për të komunikuar me publikun për çështje si diskutimi për buxhetin e bashkisë, paketës fiskale, tjetërsimit të pronave, miratimi i standarteve e rregulloreve etj, me qëllim pjesëmarrjen aktive në vendimmarrje të komunitetit.

Parim i një procesi të drejtë vendimmarrës është që: “Ai që ka përgjegjësinë për të vendosur duhet të dëgjojë”. Në zbatim dhe të këtij parimi del si detyrë që çdo këshilltar për aktet normative, të cilat do të diskutohen dhe vendosen në këshill, të marrë opinionet dhe vërejtjet e publike në lagjen ose komunitetin ku ai përfaqësohet. Me kaq po e mbyll.

Ju uroj punë të mbarë për vitin 2024 dhe faleminderit për kontributin e secilit prej jush!

- Kalojmë **në diskutim**. Fjalën e ka kërkuar znj. Kasa.

Flutura Kasa : Kam 2 pyetje shkurt.

Policia Bashkiake çfarë masash do të marrë përfundimisht për makinat, që parkohen në parkimet që janë caktu për komunitetin dhe rrinë nga 1 muaj 2 muaj shkruajë shitet aty, kurse ne vimë vërdallë para shpisë tonë dhe s’kemi vënd ku me parku makinën. E kam ngrit disa herë këtë problem direkt me drejtorin e Policisë Bashkiake e prap s’po gjen zgjidhje. Çuditërisht dje, dje që do t’i ketë shkuar ajo pyetja ime, makinat u zhdukën para shtëpisë sime, domethënë që kur duan ato i zgjidhin. Kaq dhe e dyta.

Është bërë shumë problematikë tek rruga dytësore që hyp te Ura Daj Lanit, gropat e tmerrshme që janë, çfarë do të bëj kjo Ndërmarrja Rruga -Urës për këtë, është kangrenë ajo e kemi mush 100 herë ne familjarët ajo prap është...

Dorian Isaj : S’ka asfalt

Flutura Kasa : S’ka asfalt ndoshta, më vonë po e blejmë vet. Kaq kisha.

Ani Dyrmishi: Po, z. Kallmi.

Gentian Kallmi : Përshëndetje !

Faleminderit për pyetjet.

Në lidhje me çështjen e parkimit është një situatë e njohur nga ne që është problematike. Forcat e Policisë Bashkiake janë në terren për kontrol , por edhe nga denoncimet siç mund të ketë qenë dhe rasti juaj konkret dje. Është një çështje që kërkon impenjim por dhe një kuadër ligjor të saktë, por gjithsesi ne shpresojmë dhe jemi gjithmonë në krah të qytetarëve për zgjidhjen e kësaj problematike.

Probleme ka. Gjithsesi unë ju informoj të gjithëve se në raste konstatimi të na informoni sepse jo çdo gjë....

Flutura Kasa : Do jua sjell juve direkt se jam lodhur tu u marr me Policinë Bashkiake, se jam bërë si fotoreportazh.

Gentian Kallmi : Dhe përsa i përket çështjes së rrugëve si çdo vit është një procedurë rutinë, me miratimin e buxhetit, Ndërmarrja Rruga dhe Bashkia Durrës, planifikon fonde të veçanta për infrastrukturën rrugore. Kemi filluar proceurat në bazë të legjislacionit për prokurimin publik për lidhjen e kontratave dhe marrjen e masave për zgjidhjen e këtyre problematikave. Sepse ka rrugë që kanë nevojë për riparime, siç e cituat dhe ju për gropat, ka dhe rrugë që kanë nevojë për rikualifikim. Gjithsesi edhe në këtë rast nëse keni konkretisht rrugë që ju mendoni që ka problematika mund të na i referoni.

Ani Dyrmishi: Faleminderit z. Kallmi.

Fjalën se ka kërkuar njeri tjetër.

Dritan Burgija : Një sekond të lutem.

Se unë e dhashë përgjigjen për punën e bonusit të qerasë, po tha në fund fare do të na e japi një shpjegim.

Gentian Kallmi : Atëherë, përsa i përket bonusit të qerasë....

Flutura Kasa : Ti e the.

Dritan Burgija : Unë e thashë po ç'a do na thoni ju.

Gentian Kallmi : Atëherë Bashkia Durrës nëpërmjet buxhetit që ka, ju e dini të gjithë që të ardhurat e bashkive, të ardhurat vendore nuk janë të palimitueshme. Këtë vit siç e jeni njohur dhe tek relacioni i hartimit të buxhetit, Bashkia Durrës nëpërmjet parashikimit të saj ka vendosur, ka ndjekur politikën që një pjesë e mirë e investimeve me buxhetin e bashkisë të shkojnë për rindërtimin, për riaftësimin strukturor të disa objekteve të lëna pezull, duke arsyetuar që fondet të shkojnë në drejtimin e zgjidhjes së problematikës sesa në zvarritjen e saj. Me zgjidhjen e

problematikës, dhe kjo vjen politikë disavjeçare, në bazë të mundësive tona financiare. Shpresojmë që të marrë rrugë dhe sistemimi i banorëve dhe moskërkesa për bonuse pastaj.

Ani Dyrmishi: Faleminderit z. Kallmi.

Mbledhjen e deklaroj të mbyllur.

Ky procesverbal mbyllet me nr. rendor 19 (nëntëmbëdhjetë) faqe, i cili pasi verifikohet firmoset nga kryetari i këshillit, sekretari i këshillit dhe 3(tre) këshilltarë.

Mbajtësi i procesverbalit: Dorina Milja

Komisioni i Verifikimit të Procesverbalit :

Kryetar i Këshillit Bashkiak :

ANI DYRMISHI

Sekretar i Këshillit Bashkiak :

DORINA MILJA

Zëvendëskryetar i Këshillit :

ALNEIDA RROSHI

Zëvendëskryetar i Këshillit :

EDLIRA DEVOLLI

Kryetar i Gr. Këshilltarëve Demokrat:

DRITAN BURGJIA